



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002777/6

Tiranë ___/___/2021

Lënda : *Rekomandim për dhënien e masës disiplinore oficerit të policisë gjyqësore Ilir Bishtaja, efektiv i Komisarariatit të Policisë Durrës, për kontroll të paligjshëm të banesës së shtetasit G.K. dhe analizimin e qëndrimit indiferent e pasiv të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës lidhur me këtë rast.*

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
TIRANË**

**PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
TIRANË**

**KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË
TIRANË**

**Për dijeni: PRESIDENCËS SË REPUBLIKËS
TIRANË**

Të nderuar,

Në institucionin e Avokatit të Popullit nga Presidenca e Republikës na është dërguar ankesa e shtetasit H.I. Ankuesi shkruan se në datën 28.08.2020, rreth orës 20:00, dhëndri i tij i quajtur G.K. me banim në fshatin Shënepremte të Bashkisë Divjakë ka qenë duke pirë një kafe në një lokal të këtij qyteti. Aty kanë shkuar disa punonjës të Komisarariatit të Policisë Durrës, të cilët i lidhën duart me pranga me pretendimin se ai ishte autor i vjedhjes së disa bizhuterive në një dyqan në Durrës. Pas këtij veprimi, ata e kanë çuar në banesën e tij dhe kanë bërë kontrollin e saj. Sipas ankuesit, gjatë arrestimit të shtetasit G.K. punonjësit e policisë e kanë dhunuar atë. Më pas ata e kanë shoqëruar në Komisariatin e Policisë Durrës ku e kanë mbajtur 16 orë të arrestuar. Pas verifikimeve të bëra, ai është lënë i lirë sepse në orën në të cilën kishte ndodhur vjedhja, G. ka qenë duke lyer një banesë në qytetin e Lushnjës ku është filmuar edhe nga kamerat që ndodheshin aty.

Gjithashtu ankuesi pretendon se nga ky veprim i kryer nga punonjësit e policisë, G. dhëndrit të tij i është shkaktuar një dëm i madh fizik dhe moral. Për këtë arsye, ai kërkon ndëshkimin e autorëve të këtyre veprimeve të kundërligjshme.

Në bazë të kërkesës tonë, Komisariati i Policisë Durrës me shkresën nr. 7020/1 prot., datë 28.09.2020 ndërmjet të tjerave na informoi se, shtetasi G.K. ka qenë person i dyshuar për vjedhjen e banesës së shtetasit K.E.. Nga deklaratimet e bëra nga shtetasi Xh.E., i biri i shtetasit K.E., policia është informuar se gjatë këqyrjes së pamjeve filmike që ka marrë nga një biznes pranë pallatit ka vënë re dy persona të dyshuar, të cilët hyjnë në një automjet me ngjyrë blu, me targa AA 431 JN dhe se nga verifikimet e bëra në sistem ky automjet i përket shtetasit G.K., banues në Divjakë. Pas komunikimeve me prokurorin, duke qenë në gjendjen e flagrancës, bazuar në nenin 125 të Kodit të Procedurës Penale dhe meqënëse bëhej fjalë për vjedhjen e një shume të konsiderueshme parash, shërbimet e policisë kanë shkuar në banesën e tij në Divjakë dhe kanë bërë kontrollin e saj, por nuk është gjetur ndonjë gjë e kundërligjshme. Pas kësaj është bërë shoqërimi i shtetasit G.K. në Komisaratin e Policisë Durrës dhe është pyetur me cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit. Ai është regjistruar në regjistrin e personave në orën 00:30, ka qëndruar në ambientin e pritjes së qytetarëve deri në orën 07:24 të datës 29.08.2020.

Gjithashtu në këtë shkresë u vumë në dijeni se materialet për këtë ngjarje i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, e cila ka regjistruar procedimin penal nr. 1680/2020 dhe ndiqet nga prokurorja Rabiana Halili.

Përveç sa më sipër u informuam se ndaj këtij personi nuk është ushtruar dhunë fizike apo psikologjike nga shërbimet e policisë.

Së bashku me përgjigjen Komisariati i Policisë Durrës na dërgoi edhe fotokopje të materialeve procedurale të administruara lidhur me këtë ngjarje si: informacioni për referimin e veprës penale tek prokurori; procesverbalet e pyetjes së shtetasve K.E., Xh.E., G.E., G.K.; si dhe proceverbali i kontrollit të banesës së shtetasit G.K. .

Pas dërgimit të përgjigjes nga Komisariati i Policisë Durrës, për të marrë më shumë informacion i kërkuam Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës të na informonte lidhur me sa më poshtë vijon:

1. A është bërë nga ky organ vleftësimi i kontrollit të banesës në pronësi të shtetasit G.K. të ushtruar nga punonjësit e Komisarimit të Policisë Durrës në datën 28.08.2020 në orët e natës në bazë të nenit 298/4 të Kodit të Procedurës Penale?
2. Nëse po, si ka rezultuar ai i ligjshëm apo jo?
3. Çfarë veprimesh procedurale janë kryer nga organi i prokurorisë në lidhje me materialet e referuara nga Komisariati i Policisë Durrës në lidhje me këtë rast dhe shtetasin G.K.?
4. Së bashku me informacionin i kërkuam të na dërgohej edhe fotokopje e vendimit të vleftësimit të kontrollit të banesës në pronësi të shtetasit G.K. .

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me shkresën nr. 2266/1-k prot., datë 20.12.2020, ndërmjet të tjerave na informoi se mbi bazën e referimit të Policisë Gjyqësore të Komisarimit të Policisë Durrës ky organ ka regjistruar procedimin penal nr. 1680, për veprën penale të vjedhjes parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal.

Nga aktet e fashikullit të hetimit ka rezultuar se në datën 28.08.2020, Salla Operative e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, ka marrë dijeni për vjedhjen e ndodhur në banesën e shtetasit K.E., në lagjen nr. 5 Durrës. Në lidhje me këtë ngjarje janë kryer veprimet e

para hetimore, ndërmjet të cilave edhe kontrolli i banesës së shtetasit G.K. në Divjakë. Kontrolli është ushtruar në datën 28.08.2020, ora 22:30 deri në orën 23:00.

Materialet hetimore janë referuar në organin e prokurorisë në datën 01.09.2020, tej afatit 48 orë, të përcaktuar në nenin 298 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë informacion nuk është shënuar nëse është komunikuar ose jo për këtë rast me prokurorin e gatshëm.

Materiali i mësipërm i ka kaluar prokurores Rabiana Halili me shortin e organizuar në datën 03.09.2020. Nga ana e prokurores është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal me urdhrin e datës 08.09.2020.

Prokurorja Rabiana Halili aktualisht është larguar nga detyra me vendimin nr. 201, datë 30.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për shkak të dorëheqjes.

Me vendimin e datës 13.10.2020, Prokurore Rabiana Halili është zëvendësuar me prokuroren F. Reka.

Në aktet e fashikullit hetimor rezulton se nuk është marrë asnjë vendim për vleftësimin e kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit G.K. në datën 28.08.2020.

Nga shqyrtimi i ankesës së shtetasit H.I., i përgjigjeve të dërguara institucionit tonë nga Komisariati i Policisë Durrës dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, si dhe i dokumentacionit shoqërues konstatojmë se pretendimet e ngritura në ankesë nga shtetasi H.I. ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë Durrës për ushtrimin e kontrollit të banesës së dhëndrit të tij, shtetasit G.K. në kundërshtim me ligjin janë të drejta.

Veprimi procedural si mjet i kërkimit të provës i kontrollit të banesës së shtetasit G.K., nuk është kryer në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, sepse nuk ka patur arsye të bazuara për të kryer kontrollin e banesës së tij, si dhe nuk ka qënë një veprim i ngutshëm për të cilin nuk mund të pritej vendimi i organit procedues. Në vlerësojmë se ky veprim procedural i kryer me iniciativë nga oficeri i policisë gjyqësore Ilir Bishtaja vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Sjellim në vëmendje se neni 298¹ i Kodit të Procedurës Penale, i cili lejon realizimin e kontrollit të personit ose të vendeve me iniciativë nga policia gjyqësore, përcakton qartë

¹ **Neni 298 “Kontrollimet”**

1. Në rast *flagrance* ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të lokalit kur kanë arsye të bazuara të mendojnë se mbi personin gjenden të fshehura sende ose gjurmë të veprës penale që mund të zhduken a të humbasin ose që këto sende a gjurmë ndodhen në një vend të caktuar ose atje ku gjendet personi nën hetim ose i ikur.

2. Kur duhet të kryhet një ndalim, të ekzekutohet një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim, oficerët e policisë gjyqësore mund të bëjnë kontrollin e personit ose të lokalit, kur ekzistojnë kushtet e treguara në paragrafin 1 dhe ka arsye të veçanta urgjence që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli. Kur vonesa mund të dëmtojë përfundimin e suksesshëm të hetimeve, kontrolli i banesës mund të bëhet edhe jashtë kohës së parashikuar në nenin 206.

3. Në rastet e *flagrancës* apo ndjekjes së personit në ikje ose kur duhet të kryhet një ndalim ose të ekzekutohet një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim, policia gjyqësore merr të gjitha masat teknike, me qëllim sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave origjinale kompjuterike dhe mbrojtjen e tyre nga humbja, dëmtimi dhe tjetërsimi, si dhe kryen kontrollimet e mëtejshme të të dhënave kompjuterike, kur ka shkaqe të arsyeshme se ato përmbajnë informacion, programe apo gjurmë të veprës penale.

4. Procesverbalit i veprimeve të kryera i dërgohet menjëherë, por jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është bërë kontrolli, i cili brenda dyzet e tetë orëve vijuese procedon sipas nenit 301 të këtij Kodi.

që një veprim i tillë hetimor mund të kryhet në raste flagrante, në rast ndjekje të personit që ka qenë duke ikur ose në kuadër të zbatimit të një vendimi arresti, ndalimi ose vendimi dënimi me burgim. Në rastin konkret, personi të cilit i është kontrolluar banesa shtetasi G.K., nuk ka qenë në gjende flagrante, pasi policia gjyqësore nuk ka proceduar me arrestimin e tij. Ky shtetas nuk ka qenë duke ikur, fshehur dhe iu shmangur procedimit penal. Policia gjyqësore nuk ka proceduar me kryerjen e një arrestimi, ndalimi si dhe nuk ka qenë në kushtet e zbatimit të një vendimi dënimi me burgim. Ndërkohë rezulton se nga policia gjyqësore nuk është administruar asnjë e dhënë konkrete, për të justifikuar se ka arsye të bazuara të mendojë se mbi personin gjenden të fshehura sende ose gjurmë të veprës penale që mund të zhduken a të humbasin ose që këto sende a gjurmë ndodhen në një vend të caktuar ose atje ku gjendet personi nën hetim ose i ikur.

Nga policia gjyqësore nuk është administruar asnjë e dhënë konkrete që krijon dyshime të arsyeshme ndaj shtetasit G.K. se ai ka kryer veprën penale të vjedhjes, parashikuar nga neni 134 të Kodit Penal apo elemente të ndonjë veprë tjetër penale. Policia gjyqësore ka referuar vetëm faktin se nga deklaratimet e shtetasit Xh.E. është dhënë një informacion se dy vjedhësit e dyshuar të banesës së shtetasit K.E. kanë komunikuar me drejtuesin e mjetit me targë AA 413 JN dhe se nga verifikimet e bëra nga deklaruesi kjo makinë i përket shtetasit G.K.. Por nuk ka kryer veprime hetimore me qëllim grumbullimin e provave për autorësinë e veprës penale konkrete dhe individualizimin e përgjegjësishë së autorit të saj, detyrim i cili rrjedh nga parashikimet e nenit 30², 293³ dhe 294⁴ të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nga dispozitat e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të cilat lidhen

² Neni 30 “Funksionet e policisë gjyqësore”

1. Policia gjyqësore, edhe me iniciativën e vet, duhet të marrë dijeni për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal.

2. Policia gjyqësore kryen çdo veprim hetimor që i është urdhëruar ose deleguar nga prokurori.

3. Funksionet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2, të këtij neni, kryhen nga oficerët policisë gjyqësore. Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit kanë statusin e oficerit të policisë gjyqësore.

³ Neni 293 “Referimi i veprës penale te prokurori”

1. Me marrjen e njoftimit për një vepër penale, policia gjyqësore, pa vonesë, por jo më vonë se 72 orë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra. Ajo njofton, kur është e mundur, edhe gjeneralitetet, banesën dhe çdo gjë që vlen për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit.

2. Kur ka urgjencë dhe në rastet e krimeve të rënda, njoftimi bëhet menjëherë edhe me gojë, i cili nuk përjashton detyrimin për të referuar me shkrim.

3. Me njoftimin, policia gjyqësore, gjithashtu, tregon ditën dhe orën në të cilën ka marrë dijeni për veprën penale.

⁴ Neni 294 “Sigurimi i burimeve të provave”

1. Edhe pas referimit të veprës penale policia gjyqësore vazhdon të kryejë funksionet e treguara në nenin 30, duke grumbulluar e fiksuar çdo element të vlefshëm për rindërtimin e faktit dhe për individualizimin e fajtorit. Ajo procedon sidomos:

a) për kërkimin dhe fiksimin e sendeve dhe të gjurmëve të veprës penale, si dhe për ruajtjen e tyre dhe të vendit të ngjarjes për aq kohë sa kjo gjë është e domosdoshme;

b) për kërkimin dhe pyetjen e personave që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit;

c) për kryerjen e veprimeve të caktuara në nenet vijuese.

2. Pas ndërhyrjes së prokurorit, policia gjyqësore kryen çdo veprim të urdhëruar ose të deleguar posaçërisht nga prokurori, si dhe kryen me iniciativë çdo veprim hetimor të nevojshëm dhe siguron burime të reja të provës.

3. Kur kryen veprime që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, me iniciativën e saj ose të deleguara nga prokurori, policia gjyqësore mund të caktojë ekspertë, të cilët nuk mund të refuzojnë detyrën e ngarkuar, pa shkaqe të ligjshme.

me parandalimin, zbulimin dhe kapjen e autorëve të veprave penale, mbledhjen e informacioneve, bashkëpunimin me individë dhe informimin.

Përveç sa më sipër, theksojmë se edhe gjatë kontrollit të banesës, nuk janë gjetur sende që lidhen me veprën penale dhe as sende të tjera të kundërligjshme.

Në rastin konkret nga policia gjyqësore nuk janë respektuar as dispozitat ligjore të parashikuara në nenet 116⁵, 117⁶ dhe 118⁷ të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, të cilat normojnë të gjithë veprimtarinë e punonjësve të Policisë së Shtetit, të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë kryerjes së detyrës, ndër to edhe e drejta për të ushtruar kontroll në ambiente private.

⁵ Neni 116 “Kontrolli i objekteve dhe automjeteve”

1. Një objekt, me përjashtim të mjediseve të përcaktuara në nenin 118, të këtij ligji, kontrollohet nëse:

a) zotërohet nga personi që është kontrolluar sipas nenit 119, të këtij ligji;

b) faktet bëjnë të dyshohet se brenda objektit ndodhet personi:

i) që duhet të arrestohet ose të ndalohet;

ii) që është mbajtur në mënyrë të jashtëligjshme;

iii) për të cilin punonjësi i policisë ka dyshime të bazuara se kontrolli është i nevojshëm për mbrojtjen e jetës nga një rrezik i çastit;

c) faktet bëjnë të dyshohet se aty ndodhet një send që mund të sekuestrohet.

2. Kontrollohet automjeti në të cilin ndodhet personi, identiteti i të cilit mund të verifikohet në një pikë kontrolli. Kur ekziston një nga kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kontrolli bëhet edhe ndaj sendeve brenda automjetit.

3. Përdoruesi i objektit dhe/ose i mjetit ka të drejtë të jetë i pranishëm gjatë kontrollit. Nëse ai nuk paraqitet, ftohet një përfaqësues apo dëshmitar tjetër. Përdoruesit duhet t'i dorëzohet një kopje e procesverbalit të kontrollit dhe arsyet, nëse kërkohen prej tij.

⁶ Neni 117 “Ndërhyrja në mjedise”

1. Mjedise, në kuptim të këtij neni, janë banesat dhe dhomat ngjitur me to, zyrat e punës, garazhet, magazinat, kapanonet, bodrumet, mjediset e veprimtarisë profesionale, tregtare, blegtorale, bujqësore, si dhe çdo pronë tjetër private që lidhet me to.

2. Ndërhyrja dhe kontrolli në mjedise mund të bëhen pa lejen e pronarit nëse:

a) është e nevojshme të parandalohet një kërcënim i çastit për jetën dhe shëndetin;

b) në çdo rast të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale.

3. Nëse pronari apo personi që zotëron mjedisin ose përfaqësuesi i tij nuk janë të pranishëm gjatë ndërhyrjes, sipas pikës 1, të këtij neni, duhen njoftuar menjëherë për arsyen e kontrollit për sa kohë që qëllimi i masës së marrë nuk vihet në rrezik.

4. Në të gjitha rastet e hyrjes dhe të kontrollit, sipas këtij neni, punonjësi i policisë harton një procesverbal në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, ku ndër të tjera përmenden arsyet e hyrjes, kryerjes së kontrollit dhe rezultatet e tij. Një kopje e këtij raporti i jepet, sipas kërkesës, personit të interesuar ose personave të autorizuar prej tij.

⁷ Neni 118 “Kontrolli kundër akteve terroriste”

1. Punonjësi i policisë, kur ka dyshime të arsyeshme ka të drejtë të kryejë me iniciativë kontrolle për parandalimin e akteve terroriste në banesa, ndërtesa, mjedise dhe hapësira publike për të garantuar sigurinë e personave dhe të rendit kushtetues kombëtar e sigurinë ndërkombëtare.

2. Kontrolli kundër akteve terroriste përfshin kontrollin për eksplozivë, lëndë helmuese kimike, biologjike, bakteriologjike apo radioaktive.

3. Këtë të drejtë e ushtron në rastet e flagrancës, në rast ndjekjeje të personit, si dhe kur ka prova apo informacione të besueshme se është duke u përgatitur një akt terrorist dhe kur nga vonesa e ushtrimit të kontrollit mund të zhduken ose të humbasin mjetet ose gjurmët e kryerjes së krimit.

4. Pas ushtrimit të kontrollit, punonjësi i policisë harton procesverbalin përkatës dhe ia dërgon brenda 48 orëve prokurorit të vendit ku është bërë kontrolli. Një kopje e procesverbalit i lihet pronarit ose poseduesit të objektit apo personit të kontrolluar.

5. Personi i kontrolluar nga policia ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën kompetente ku ndodhet struktura policore, nëse e konsideron kontrollin si të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin.

Nga analizimi i këtyre dispozitave konstatojmë se në rastin konkret punonjësit e policisë nuk kanë qenë në kushtet ligjore për të cilat ligji u ka dhënë atyre atributin për të ndërhyrë dhe për të ushtruar kontrolle në mjediset dhe ambientet e personave privatë. Punonjësi i policisë gjyqësore Ilir Bishtaja ka referuar në organin procedues vetëm se ka marrë informacion se dy autorët e dyshuar të vjedhjes së banesës së shtetasit K.E. kanë komunikuar me drejtuesin e automjetit me targë AA 413 JN. Por në materialin e referuar në organin procedues nuk ka asnjë akt procedural i cili provon administrimin e një informacioni të tillë. Ndërkohë që si ligji i posaçëm i cili rregullon veprimtarinë e punonjësve të Policisë së Shtetit, ashtu edhe dispozitat konkrete procedurale që normojnë rastet dhe kriteret që duhet të plotësohen për ushtrimin e kontrollit me iniciativë, nuk legjitimojnë ndërhyrjen e pa autorizuar në rastin e mësipërm. Në këto raste plotësimi dhe respektimi me rigorozitet i rregullave ligjore që legjitimojnë ushtrimin e kontrollit në ambiente private merr një rëndësi të posaçme nisur nga fakti se në këto situata kemi një cenim të së drejtës kushtetuese të privatësisë e garantuar nga neni 37 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ.

Theksojmë se ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit i cili në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ka përcaktuar në mënyrë eksplicite dhe pa asnjë ekuivok rastet dhe kushtet kur punonjësit e policisë mund të ushtrojnë kontroll në ambiente private. Ndërkohë vlerësojmë se këto shkelje të të drejtave ligjore të shtetasve cenojnë edhe imazhin e Policisë së Shtetit dhe trondisin besimin e publikut tek ky organ i sigurisë së rendit publik. Shkelja e këtyre rregullave përveç të tjerave përbën shkak për përgjegjësi disiplinore.

Është e rëndësishme të sqarojmë se, sipas Komisarariatit të Policisë Durrës shkak për ushtrimin e kontrollit të banesës së shtetasit G.K. nga oficeri i policisë gjyqësore Ilir Bishtaja kanë qenë deklaratimet e bërë nga shtetasi Xh.E., i biri i pronarit të banesës së vjedhur, shtetasit K.E.. Sipas deklaratimit të shtetasit Xh.E. të pasqyruar në procesverbalin e datës 28.08.2020 rezulton se, *gjatë këqyrjes së pamjeve filmike që ai i ka marrë nga një biznes pranë pallatit ku ndodhet banesa e vjedhur, ka vënë re dy persona të dyshuar të cilët janë futur në pallatin e tij në orën 10:46 dhe kanë dalë në orën 11:50. Ata pasi kanë dalë nga hyrja e pallatit kanë komunikuar me drejtuesin e një automjeti me ngjyrë blu, me targa AA 431 JN.* Ndërkohë ky shtetas në procesverbalin e mbajtur në datën 30.08.2020 nga oficeri i policisë gjyqësore Ilir Bishtaja ka deklaruar se, *nga verifikimet e bëra në kompjuter me rezolucion të lartë të pamjeve filmike të marrë në dyqanin e elektroshtëpiakeve ka rezultuar, se targa e mjetit të dyshuar duhet të jetë AA 476 UN.*

Ndërsa nga deklaratimet e bëra nga shtetësja G.E., e bija e shtetasit K.E., në procesverbalin e mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore Ilir Bishtataja në datën 29.08.2020, pasqyrohet se, *nga këqyrja e pamjeve filmike që ka parë vëllai Xh.E. në kamerat e një dyqani elektroshtëpiake është konstatuar një automjet tip benz me targa AA 431 JN, me të cilin janë larguar dy personat e dyshuar që kanë dalë nga hyrja e pallatit ora 11:50.*

Po kështu, shtetasi K.E. në deklaratimet e dhëna në procesverbalin e mbajtur në datën 29.08.2020 nga oficeri i policisë gjyqësore Ilir Bishtataja është shprehur se, *nga këqyrja e pamjeve filmike që ka parë djali Xh.E. në kamerat e një dyqani elektroshtëpiake është konstatuar një automjet tip benz me targa AA 431 JN, ngjyrë bojëqielli me të cilin janë larguar dy personat e dyshuar që kanë dalë nga hyrja e pallatit ora 11:50.*

Ndërsa nga procesverbali i pyetjes së shtetasit G.K. në datën 29.08.2020 nga oficeri i policisë gjyqësore Ilir Bishtaja rezulton se ai (G.) që para 4-5 vjetësh ***ka në posedim të regjistruar në emrin e tij automjetin tip benz me targa AA 431 JN, ngjyrë gri.***

Pra, sikurse rezulton nga deklaratimet e cituara më sipër, deklaruesit nuk janë të saktë lidhur me identifikimin e automjetit me të cilin janë larguar dy personat e dyshuar si autorë të vjedhjes së banesës së shtetasit K.E., lidhur me të gjitha karakteristikat e tij si për ngjyrën ashtu edhe për targën. Por edhe vetë personi që i ka parë pamjet filmike nuk është korrekt në deklaratimet e bëra lidhur me targën e automjetit, sepse njëherë ka deklaruar se ***ajo është AA 413 JN*** dhe herën tjetër ka deklaruar se ***duhet të jetë AA 476 UN***. Ndërkohë ka rezultuar që, automjeti i personit të dyshuar i cili ka komunikuar/apo ka transportuar autorët e dyshuar të vjedhjes së banesës, ***ka ngjyrë gri dhe jo blu e as bojë qielli.***

Nga deklaratimet e shtetasve të cituar më sipër konstatojmë se nuk ka përputhje lidhur me dyshimet ndaj drejtuesit të mjetit, si njëri nga autorët e përfshirë në vjedhjen e banesës në fjalë. Personi që i ka parë pamjet filmike, shtetasi Xh.E., ka deklaruar se ***dy autorët e dyshuar të vjedhjes së banesës pasi kanë dalë nga hyrja e pallatit kanë komunikuar me drejtuesin e një automjeti me ngjyrë blu, me targa AA 431 JN.*** Ky deklarim i tij është pasqyruar edhe në informacionin për referimin e veprës penale të prokurori, i përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore Ilir Bishtaja.

Ndërsa shtetasit K. dhe G.E kanë deklaruar se ***dy personat e dyshuar janë larguar me automjet tip benz me targa AA 431 JN.*** Kjo mospërputhje mund të ketë ndodhur ose për shkak se në këtë mënyrë është deklaruar nga ana e tyre, ose për pakujdesi të oficerit të policisë gjyqësore kur ka administruar deklaratimet e personave të cituar më sipër në procesverbalet përkatës. Por, nëse e vërteta është sikurse ka deklaruar shtetasi Xh.E., i cili është burimi i drejtpërdrejtë i këtij informacioni për policinë, komunikimi i autorëve të dyshuar të vjedhjes me drejtuesin e automjetit me targa AA 431 JN nuk përbën e nuk mund të përbëjë ndonjë provë që e ngarkon atë me dyshime si bashkëautor i vjedhjes së banesës. Komunikimi i dy autorëve të dyshuar me drejtuesin e automjetit/apo largimi i tyre me këtë automjet mund të ketë qenë i rastësishëm, por ky informacion duhej të vlerësohej nga policia gjyqësore për të organizuar punën operative-hetimore e për të siguruar prova që fajësojnë autorët e veprës penale në fjalë.

Ne konstatojmë se nga dokumentacioni i dërguar nga Komisariati i Policisë Durërs nuk rezulton që të jetë bërë ndonjë verifikim paraprak nga policia gjyqësore i informacionit të dhënë nga djali i pronarit të banesës së vjedhur, sikurse do të ishte sekuestrimi i pamjeve filmike të regjistruara nga kamerat e bizneseve pranë vendit të ngjarjes dhe këqyrja e tyre konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, por ai është marrë i mirëqenë.

Ndërkohë nga ana e oficerit të policisë gjyqësore nuk është bërë verifikimi i automjetit të shtetasit G.K. as në momentin para se të fillonte ushtrimin e kontrollit të banesës së këtij të fundit, kur shkoi në vend për të kryer këtë veprim procedural. Nëse do ta kishte bërë këtë verifikim, kemi bindjen se ai nuk do ta kryente kontrollin e banesës sepse të dhënat e automjetit, të paktën ngjyra, nuk përputhej me ato të deklaruara nga shtetasi Xh.E. dhe kështu do të parandalonte kundërligjshmërinë e veprimit të mëvonshëm. Këto verifikime janë të domosdoshme sepse sikurse ka ndodhur edhe më parë në mjaft raste, autorët e veprave penale të ndryshme para se të kryenin aktin kriminal kanë vjedhur automjete në pronësi të persona të tjerë, kanë vjedhur targat e automjeteve të tjera apo kanë vendosur targa false në automjetet të cilat i kanë përdorur gjatë kryerjes së veprave penale. Kuptohet që këto veprime bëhen me qëllim për të fshehur gjurmët e autorësisë dhe vështirësuar punën e policisë për identifikimin dhe kapjen e tyre. Edhe në këtë rast mund të ketë

ndodhur që, ose deklaruesi është i pasaktë në deklaratimet e dhëna para organit të policisë lidhur me karakteristikat e automjetit dhe targën e tij ose targa e automjetit në fjalë mund të ketë qenë false.

Theksojmë se në rastin konkret, koha e ushtrimit të kontrollit të banesës së shtetasit G.K. nga ora 22:30 deri në orën 23:00 është bërë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 206⁸ të Kodit të Procedurës Penale. Pra, ajo jo vetëm që është bërë jashtë afatit ligjor të lejuar, por edhe pa patur urdhër me shkrim të organit procedues.

Arsyetimi i Komisarariatit të Policisë Durrës se për ushtrimin e kontrollit të banesës së shtetasit G.K. është komunikuar me prokurorin e gatshëm nuk qëndron dhe rrëzohet nga përgjigjia e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës të cilën e cituam më sipër. Ndërkohë sjellim në vëmendje se zbatimi korrekt i dispozitës së cituar më sipër kërkon urdhër me shkrim të organit procedues për të ushtruar kontrollin e banesës jashtë orarit të lejuar.

Gjithashtu kontatua se materialet hetimore janë referuar në organin e prokurorisë në datën 01.09.2020, tej afatit ligjor 72 orë, të përcaktuar në nenin 293/1⁹ të Kodit të Procedurës Penale. Ndërkohë edhe procesvebali i kontrollit të banesës në pronësi të shtetasit G.K. të ushtruar nga oficeri i policisë gjyqësore Ilir Bishtaja në datën 28.08.2020 nuk i është dërguar prokurorit për vleftësimin e tij brenda afatit 48 orë, sikurse parashikohet në nenin 298/4 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese konstatoam edhe një shqetësim serioz i cili lidhet me qëndrimin indiferent dhe pasiv të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës lidhur me shkeljet ligjore të kryera nga policia gjyqësore në këtë rast. Nga përgjigjia e dërguar rezulton se ky institucion nuk është shprehur lidhur me vleftësimin e kontrollit të ushtruar nga oficeri i policisë gjyqësore Ilir Bishtaja në banesën e shtetasit G.K., por mjaftohet me konstatimin se nuk ka vendim për vleftësimin e tij. Po ashtu, ky institucion nuk shprehet as lidhur me kohën e ushtrimit të këtij kontrolli, i cili është bërë tej afatit ligjor të lejuar dhe pa urdhër me shkrim të organit procedues. Ndërkohë, ndonëse organi i prokurorisë ka konstatuar që materialet hetimore janë dërguar tej afatit ligjor nga policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë Durrës, mjaftohet me kaq dhe nuk rezulton që të ketë ndërmarrë fillimin e procedimit disiplinor për analizimin e këtij rasti dhe ndëshkimin e personave përgjegjës¹⁰ në bazë të nenit 32 e vijues të ligjit nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen.

⁸ **Neni 206 “Koha për kryerjen e kontrollit të banesës”**

1. Kontrolli në një banesë ose në një vend të mbyllur ngjitur me të nuk mund të fillojë para orës shtatë dhe pas orës njëzet. Në raste të ngutshme organi procedues mund të urdhërojë me shkrim që kontrolli të bëhet tej këtyre caqeve.

⁹ **Neni 293 “Referimi i veprës penale te prokurori”**

1. Me marrjen e njoftimit për një veprë penale, policia gjyqësore, pa vonesë, por jo më vonë se 72 orë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra. Ajo njofton, kur është e mundur, edhe gjeneralitetet, banesën dhe çdo gjë që vlen për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit.

¹⁰ **Neni 35 “Subjekte që kanë të drejtën e fillimit të procedimit disiplinor”**

1. Procedimi disiplinor fillon brenda 6 muajve nga zbulimi i shkeljes, por jo më vonë se tre vjet nga kryerja e saj.

2. Të drejtën për të kërkuar fillimin e procedurës disiplinore e kanë subjektet e mëposhtme:

a) Prokurori i Përgjithshëm,

Ne vlerësojmë se ky qëndrim nuk është aspak korrekt dhe është qartas në kundërshtim me aktet normative në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e policisë gjyqësore, që parashikojnë atributet e saj dhe të organit të procedimit penal. Kjo sjellje nuk i shërben hetimit të veprave penale, zbulimit të autorëve dhe ndëshkimit të tyre nga organet e drejtësisë. Ndërkohë ajo sjell pasoja serioze në jetën e qytetarëve dhe cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese e ligjore.

Është rasti të theksojmë rëndësinë që ka zbatimi efektiv i të drejtave procedurale të palëve në procesin penal nga organi procedues me cilësinë e organit që drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore¹¹. Kjo sjellje lidhet jo thjesht me një detyrim ligjor që duhet të zbatohet e garantojnë organet ligjzbatuese të çdo niveli, por me parimin e procesit të rregullt ligjor dhe vlefshmërinë e akteve procedurale të administruara gjatë hetimit penal nga oficerët e policisë gjyqësore dhe /ose prokurorët.

Përveç sa më sipër, nga përgjigjja e Komisarariatit të Policisë Durrës rezulton se shtetasi G.K. është shoqëruar në këtë organ në orën 00:30 të datës 29.08.2020 dhe është lënë i lirë në orën 07:24 të kësaj date. Ndërsa nga procesverbali i kontrollit të banesës së tij rezulton që kontrolli ka filluar në orën 22:30 të datës 28.08.2020. Ky fakt provon më së miri që koha (ora) faktike e shoqërimit të tij nuk është ajo e pasqyruar në regjistër konkretisht ora 00:30, sepse në këtë rast ajo ka filluar në momentin që atij është privuar lëvizja e lirë. Sipas ankuesit, ky moment është të paktën disa minuta para ushtrimit të kontrollit të banesës, kur ai është marrë nga punonjësit e policisë në lokalën ku ishte duke pirë kafe. Ndonëse pretendimi i ankuesit, se shtetasi G.K. është mbajtur në gjendje shoqërimi për 16 orë nuk provohet, gjithsesi ora e shoqërimit të tij e pasqyruar në regjistër nuk përputhet me kohën faktike të këtij veprimi administrativ.

Sikurse kemi konstatuar edhe më parë gjatë shqyrtimit të ankesave të shtetasve apo kryerjes së inspektimeve nga strukturat e institucionit të Avokatit të Popullit në organet vendore të Policisë së Shtetit, problematika lidhur me plotësimin e pasaktë të të dhënave në regjistrin përkatës vijon të ngelet shqetësim jo i vogël. Ju sjellim në vëmendje se lidhur me këtë çështje gjatë viteve të fundit ju kemi adresuar disa rekomandime për përmirësimin e këtij procesi të rëndësishëm që lidhet drejtpërdrejtë me respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar. Ky veprim nuk është aspak korrekt dhe në përputhje me aktet normative në fuqi që rregullojnë këtë veprimtari të Policisë së Shtetit. Konkretisht, në Procedurën Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938, datë 24.07.2019, Kapitullin VIII/1/a.1.4, parashikohet evidentimi në rrugë manuale i veprimeve e të dhënave që kryhen me personat e shoqëruar. Ndërmjet të tjerave në këtë pjesë kërkohet **regjistrimi i orës dhe datës së shoqërimit të personit dhe jo i orës dhe datës së futjes së tij në ambientet e policisë**, sikurse është vepruar në këtë rast me shtetasin G.K..

b) drejtuesi i prokurorisë;

c) prokurori i çështjes për çështjen për të cilën është kryer shkelja disiplinore;

ç) titullari i institucionit shtetëror, të cilit ligji i posaçëm i njeh funksionet e Policisë Gjyqësore.

3. Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor përshkruhen në mënyrë të përmbledhur natyra e shkeljes, faktet për të cilat kërkohet të fillohet procedimi disiplinor. Kërkesa shoqërohet nga relacioni i procedimit disiplinor, i cili përmban të dhëna të detajuara për shkeljet e pretenduara disiplinore.

11 Neni 24 i K.Pr.P. “Funksionet e prokurorit”

1. Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

Të njëjtin shqetësim jua kemi bërë prezent edhe lidhur me procesverbalet e arrestimit të shtetasve të përpiluara nga oficerët e policisë gjyqësore të organeve vendore të Policisë së Shtetit, në të cilët si kohë e arrestimit/ndalimit të shtetasve vendoset ora e mbajtjes së proceverbaleve dhe jo ora faktike e arrestimit/ndalimit të tyre.

Theksojmë se, në rekomandimet e bëra është kërkuar që, edhe në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit duhet të vihet ora e shoqërimit të tyre dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit. Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, si dhe në standardet më të larta ndërkombëtare, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 258 të tij. Duke iu referuar neneve 144, 250 të K.Pr.Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilit prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Nga përgjigjet që na janë dërguar deri më tani nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit rezulton se rekomandimet e institucionit tonë janë vlerësuar të drejta dhe janë pranuar. Në zbatim të tyre janë marrë masat e nevojshme dhe janë nxjerrë akte dërguar strukturave vendore të policisë për përmirësimin e punës në të ardhmen, por konstatohet se shkelje të tilla janë ende të pranishme në veprimtarinë e përditshme të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, gjykon se, bazuar në evidentimin e problematikave të lartpërmendura, si dhe për të garantuar një sjellje profesionale e të përgjegjshme të efektivëve të policisë, domosdoshmërisht lind nevoja e një reagimi nga strukturat e Policisë së Shtetit, për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike”*, në nenin 21/c të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimeve Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”*, dhe në nenin 21/d të këtij ligjit ku parashikohet se: *“për shkelje të rënda, të vëna re, i propozon çdo organi, si dhe Kuvendit, shkarkimin e funksionarëve që janë kompetencë e tyre;”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj oficerit të policisë gjyqësore Ilir Bishtaja, efektiv i Komisarariatit të Policisë Durrës dhe ndëshkimin e tij me masë disiplinore për ushtrimin e kontrollit të banesës së shtetasit G.K. në kundërshtim me aktet normative në fuqi.

2. Marrjen e masave organizative për trajnimin në vijimësi të oficerëve të policisë gjyqësore lidhur me kryerjen e veprimeve procedurale, për njohjen dhe respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve gjatë kryerjes së misionit të tyre ligjor.
3. Marrjen e masave të nevojshme për trajnimin e punonjësve të policisë që kanë për detyrë të evidentojnë në rrugë elektronike dhe manuale të dhënat e personave në regjistrat e shoqërimit me qëllim që t'i pasqyrojnë ato në mënyrë të plotë, të saktë dhe me objektivitet.
4. Përgjithësimin e këtij rasti dhe të shkeljeve të konstatuara nga institucioni i Avokatit të Popullit në të gjitha strukturat vendore të Policisë së Shtetit, me qëllim mos përsëritjen e tyre në të ardhmen nga punonjësit e policisë.
5. Analizimin e këtij rasti nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm, nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse dhe përgjithësimin e tij me qëllim mos përsëritjen e qëndrimeve të tilla në të ardhmen si nga ana oficerëve të policisë gjyqësore ashtu edhe nga prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca

Konceptoi: S. Nushi

Miratoi: E. Ruspi